

**MBI IMPLEMENTIMIN E INTERVALIT KOHOR 15 MINUTA NË OPERIMIN E
PROCESEVE NË TREGUN E BALANCIMIT**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.2.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1203 prot., datë 25.2.2025, të përgatitur nga drejtoritë teknike “Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në tregun e balancimit”,

konstatoi se:

- ERE me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, miratoi Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike. Nga miratimi i këtyre rregullave deri më 1 Prill 2021, u realizua periudha e ushtrimit “Dry Run” për aplikimin e rregullave në tregun e balancimit, gjatë së cilës u përdor rezolucioni 1-orësh.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 51, datë 2.4.2024, pranoi pjesërisht kërkesën e OST sh.a., duke përcaktuar që proceset, përfshirë nominimet dhe llogaritjet e disbalancave, të kryhen në intervale njëorëshe deri më 1 korrik 2024.

- Megjithatë, tre nga katër ofruesit e shërbimeve të balancimit (KESH sh.a., Devoll Hydropower/Statkraft dhe Ayen AS Energy) raportuan pamundësi teknike për zbatimin e rezolucionit 15-minutësh, duke kërkuar kohë për përshtatje teknologjike dhe harmonizim rajonal. Për këtë arsye, ERE, me vendimin nr. 148, datë 25.7.2024, shtyu efektet juridike të vendimit fillestar deri më 1 mars 2025, duke i dhënë palëve kohë për përgatitjet e nevojshme teknike dhe operationale. Në vijim të kësaj vendimmarrje, referuar korrespondencës dhe seancave dëgjimore respektive rezultojnë se:

1. Zbatueshmëria e vendimit

- OST sh.a., nisi testimet për implementimin e intervalit 15-minutësh më 1 janar 2025 (shkresë e OST sh.a., datë 17.10.2024). Ky proces do të paraprihej nga një prezantim teknik me palët përgjegjëse balancuese për të siguruar një tranzicion të suksesshëm në operimin e tregut të balancimit.

2. Reagimet e pjesëmarrësve të tregut ndaj implementimit

- Shoqata AREA, me shkresën e datës 30.10.2024, vuri në dukje se përvoja mbi 10-vjeçare me HEC-et dhe një studim njëvjeçar me 60 prodhues tregojnë gabime në parashikimin e prodhimit nga 10-40%. Shoqata theksoi se mungesa e një platforme të matjes së disbalancave dhe ndërprerjeve në rrjet pengon saktësinë e parashikimeve dhe rrit kostot.

- FTL sh.a., me shkresën e datës 13.11.2024, sqaroi se proceset e nominimit dhe llogaritjes së disbalancave do të vijnë në intervale njëorëshe deri në mars 2025, ndërsa implementimi i intervalit 15-minutësh do të nisë më pas.

- AAES, me shkresën e datës 27.11.2024, kërkoi nga ERE shtyrjen e implementimit, duke argumentuar mungesën e kushteve teknike për operim në këtë sistem. Përveç mungesës së platformave për menaxhimin e energjisë 15-minutëshe, shqetësimet për çmimet më të larta të furnizimit dhe vështirësitë në tregtinë ndërkufitare ishin arsyt kryesore të kësaj kërkesë.

- FTL sh.a., me shkresën e datës 10.1.2025, kërkoi gjithashtu shtyrjen e implementimit, duke theksuar rritjen e gabimeve në parashikim dhe kostove të disbalancave gjatë testeve “Dry Run”.

3. Seancat dëgjimore për implementimin e intervalit 15-minutësh

- Më 30.1.2025, ERE organizoi një seancë dëgjimore me OST-në, OSHEE-në, KESH-in, AAES-in, AREA-n dhe FTL-në, ku u diskutuan vështirësitë teknike dhe financiare të implementimit të intervalit 15-minutësh. AREA theksoi problemet me parashikimet, FTL-ja raportoi rritje të kostove dhe disbalancave, ndërsa AAES-i ngrii shqetësime mbi mungesën e përvojës dhe sinkronizimin me ALPEX. ERE kërkoi pjesëmarrje aktive në testime dhe një vendim përfundimtar në një seancë pasuese.

- Më 17.2.2025, në seancën e dytë me pjesëmarrjen e KESH-it, “Devoll Hydropower” dhe AYEN AS, KESH sh.a. kërkoi shtyrjen e implementimit deri në fund të vitit 2025 për shkak të investimeve të nevojshme në sistemet SCADA. FTL sh.a. dhe AREA mbështetën një shtyrje deri në 1 vit, ndërsa “Devoll Hydropower” konfirmoi gatishmërinë për zbatim nga 1 mars 2025.

- E pranishme në mbledhjen e datës 27.2.2025, përfaqësuesja e AREA rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur nga AREA dhe në seancën dëgjimore.

4. Harmonizimi me Kuadrin Rregullator Evropian

- Korrespondenca e mbajtur deri më tani dhe seanca dëgjimore e datës 17.2.2025 konfirmoi se OST-ja, pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike (EU) dhe NEMO-t po veprojnë në mënyrë të koordinuar për të harmonizuar tregun e balancimit të energjisë me rregullat evropiane.

- Testet funksionale për integrimin e tregut përfunduan më 31.1.2025.

- Faza e dytë e testimeve nisi më 3.2.2025, ndërsa testet për pjesëmarrësit do të nisin më 7.4.2025.

- Pas një periudhe kalimtare, faza “Go Live” është planifikuar për më datë 11.6.2025, me lëvrimin e parë të energjisë më 12.6.2025.

- Këto masa synojnë sigurimin e përputhshmërisë me mekanizmat evropianë dhe rritjen e efikasitetit në sistemin energjetik shqiptar.

- ALPEX-i dhe OST-ja janë aktualisht pjesë e projektit për bashkimin e tregut Shqipëri–Kosovë–Maqedoni e Veriut–Greqi, duke e bërë të detyrueshme zbatimin e rregulloreve të BE-së për operimin e tregut të përbashkët evropian të ditës në avancë. Në këtë kuadër, platforma e ALPEX-it duhet të përgatitet teknikisht për të mundësuar implementimin e intervalit kohor 15 minuta në produktet e tregut të ditës në avancë, në përputhje me standardet e vendeve të BE-së pjesë e sistemit SDACA.

- Vlerësojmë se zgjatja e efekteve juridike të vendimit të ERE-s nr. 148, datë 25.7.2024, do t'i mundësonte OST sh.a. dhe pjesëmarrësve të tregut të balancimit, veçanërisht OSHB-ve, të kryejnë vlerësimet dhe ndërhyrjet e nevojshme për kalimin në rezolucionin 15-minutësh në të ardhmen. Gjithashtu, vlerësohet që t'i vendoset kusht OST-së për raportim mujor në ERE dhe kryerjen e testimeve përkatëse me pjesëmarrësit e tregut, operatorët e bursës dhe OST-të fqinje për implementimin e intervalit kohor 15 minutësh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Zgjatjen e efekteve juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 148, datë 25.7.2024, deri më 11.6.2025.

2. OST sh.a. të raportojë çdo 15 (pesëmbëdhjetë) ditë në ERE dhe të kryejë testimet përkatëse me pjesëtarët e tregut, operatorët e bursës dhe me OST-të fqinje për implementimin e intervalit kohor 15-minutësh.

3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

